



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.12.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 777 DATË 3.12.2019 “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR LIRIMIN E NJË ANËTARI, I CAKTUAR KRYETAR, TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për propozimin Kuvendit për lirimimin e një anëtari, i caktuar kryetar, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, në mbledhjen e datës 10 dhjetor 2019.

- ***Baza ligjore***

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 777 datë 3.12.2019 “Për propozimin Kuvendit për lirimimin e një anëtari, i caktuar kryetar, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” bazohet në nenin 116 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike” të ndryshuar.

- ***Qëllimi***

Me shkresat nr.3668 datë 16.10.2019 dhe 3668/2 datë 03.12.2019, Z.Illir Zela Kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka depozituar pranë Kuvendit të Shqipërisë dorëheqjen e tij nga detyra e Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

AKEP-ja është institucion i pavarur i cili mbikqyr sektorë shumë të specializuar me një zhvillim të vazhdueshëm e dinamik siç janë komunikimet elektronike dhe shërbimet postare dhe drejtohet nga Këshilli Drejtues, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

Komisioni, u njoh me dorëheqjen e Z. Zela, si dhe me relacionin që shoqëron vendimin e Këshillit të Ministrave.

- ***Përfundime***

Në përfundim të diskutimeve Komisioni u shpreh dakord me vendimin për lirimin nga detyra të Z. Ilir Zela dhe vendosi t'i propozojë seancës plenare lirimin e tij si anëtar dhe si kryetar i Këshillit Drejtues të AKEP-së.